

# Disa rekomandime për organizimin e zgjedhjeve gjatë pandemisë COVID-19

## Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi të shkurtër është të sjell disa praktika të mira rreth organizimit të zgjedhjeve duke u bazuar në disa vende të cilat kanë mbajtur zgjedhje gjatë kohës së pandemisë. Kjo me qëllim të ofrimit të disa rekomandimeve për institucionet publike, në radhë të parë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), mbi parandalimin e infektimit të qytetarëve me virusin COVID-19 gjatë ditës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që do të mbahen me 14 shkurt 2021. Në këtë kuadër, shembull i mirë për këtë qëllim janë edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujeve mbajtur më 29 nëntor 2020.

Pandemia globale e shkaktuar nga virusi COVID-19 ka pasur ndikim të konsiderueshëm në jetën sociale, ekonomike dhe politike të çdo individi. Shumë vende kanë qenë të shtyra të marrin masa që kufizojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Sipas statistikave të nxjerra nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (ang. IDEA),<sup>1</sup> 75 vende që kanë planifikuar mbajtjen e zgjedhjeve tashmë i kanë shtyrë ato, 101 vende i kanë mbajtur, kurse pesë prej tyre kanë planifikuar t'i mbajnë gjatë këtij viti. Republika e Kosovës bën pjesë në mesin e vendeve të cilat kanë planifikuar t'i mbajnë zgjedhjet gjatë kohës së pandemisë, përkatësisht zgjedhjet parlamentare të caktuara të mbahen më 14 shkurt të vitit 2021. Rastet e para me virusin COVID-19 në Kosovë janë paraqitur me 13 mars 2020 dhe tani numri i rasteve pozitive është mbi 6,000 prej të cilëve rreth 1,400 persona kanë humbur jetën. Nga kjo e deri më tani, Qeveria e Kosovës ka marr vendime të ndryshme herë duke ashpërsuar e herë duke lehtësuar masat ndaj COVID-19

<sup>1</sup> Institute for Democracy and Electoral Assistance (IDEA) 'Global Overview of Covid-19 Impact on Elections'. (2021). Mund të gjendet në Global overview of COVID-19: Impact on elections | International IDEA

varësisht prej situatës epidemiologjike të vlerësuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publike (IKSHP) i Ministrisë së Shëndetësisë. Masat të cilat janë aktive sot kanë të bëjnë me bartjen e maskës, mbajtjen dhe përdorimin e dezinfektuesit, ruajtjen e distancës dhe aplikimin e kufizimit të lëvizjes pas orë 21:30 sipas kategorizimit të komunave në tre zona. Komunitat me mbi 150 raste pozitive brenda javës bëjnë pjesë në zonën e kuqe, komunitat me numër të rasteve pozitive nga 76-149 bëjnë pjesë në zonën me ngjyrë të verdhë dhe komunitat me numër pozitiv deri në 75 raste pozitive brenda javës bëjnë pjesë në zonën me ngjyrë të gjelbër. Klasifikimi i komunave sipas tre zonave përditësohet çdo javë nga IKSHP varësisht nga numri i rasteve pozitive të regjistruara për secilën komunë.

Pavarësisht gjendjes jo të mirë me pandeminë në këtë periudhë, Republika e Kosovës do t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 14 shkurt të vitit 2021. Zgjedhjet do të mbahen pas shpërndarjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Legjislaturës së shtatë nga ushtruesja e detyrës së Presidentit znj. Vjosa Osmani. Ky vendim u morr pasi Gjykata Kushtetuese nxorri aktgjykimin me të cilin e shpalli të pavlefshëm votimin e Kuvendit për zgjedhjet e Qeverisë Hoti.<sup>2</sup>

## 1. Zgjedhjet Parlamentare në Maqedoninë Veriore

Zgjedhjet Parlamentare në Maqedoninë Veriore janë mbajtur gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, më 15 korrik 2020. Ky vend ka adaptuar rregulla të reja në procesin zgjedhor, me qëllim ruajtjen e shëndetit të qytetarëve. Vlen të përmendet se zgjedhjet parlamentare në këtë vend janë mbajtur përgjatë tri ditëve, me qëllim që të evitohet grumbullimi i votuesve brenda qendrave të votimit. Përveç kësaj, disa masat e tjera përfshijnë:

■ Votuesit kanë qenë të detyruar të mbajnë distancën

1.5m

nga njëri tjetri;

- Personat që kanë qenë të vetë-izoluara, ose aktualisht të infektuar me COVID-19, e kanë pasur mundësinë të votojnë duke e autorizuar një përfaqësues në vend të tij/saj;
- Në ditën e zgjedhjeve, para fillimit të procesit të votimit, çdo vendvotim është kërkuar që të ajroset dhe dezinfektohet;
- Votuesit kanë qenë të detyruar të mbajnë distancën 1.5 metra nga njëri tjetri;
- Votuesit kanë qenë të detyruar të vendosin maskën, dhe t'i dezinfektojnë duart para dhe pas hyrjes në vendvotim;
- Votuesit janë lejuar të tërheqin maskën për një moment në kohën kur e paraqesin dokumentin identifikues para komisionerit në vendvotim.<sup>3</sup>

## 2. Zgjedhjet Parlamentare në Serbi

Zgjedhjet parlamentare në Serbi ishin planifikuar të mbahen më 6 maj 2020, por për shkak të pandemisë COVID-19, procesi zgjedhor u shty deri më 21 qershor të të njëjtit vit. Masat e ndërmarra nga institucionet shtetërore përfshijnë:

- Mbjajtja e maskës, dorëzave dhe distancës prej një metër nga njëri-tjetri ka qenë e detyruar për të gjithë komisionerët në vendvotim;
- Në të gjitha vendvotimet u kërkuar që të vendoset poster me udhëzime për respektimin e masave kundër COVID-19;
- Video vetëdijësuese dhe mesazhe në media u transmetuan disa ditë para zgjedhjeve për të informuar votuesit për përgjegjësitë e tyre dhe si të mbrojnë shëndetin në zgjedhje gjatë pandemisë.

<sup>2</sup> Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim Nr. KO95/20, i qasshëm në: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/ko\\_95\\_20\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/ko_95_20_agj_shq.pdf)  
<sup>3</sup> International Foundation for Electoral System 'Zgjedhjet e veçanta të mbajtura dhe masat lehtësuese të marra gjatë COVID-19', (Tetor, 2020). Mund të gjendet në IFES, 'Featured Elections Held and Mitigating Measures Taken During COVID-19', October 21, 2020

### 3. Zgjedhjet Lokale në Francë

■ Në çdo vendvotim janë vendosur posterët për respektimin e masave kundër

## COVID-19

në mënyrë që të jenë sa më gjithëpërfshirës;

Franca ishte ndër vendet e para e cila ka organizuar zgjedhje pas përhapjes së virusit COVID-19. Zgjedhjet lokale në këtë vend u mbajtën në dy raunde, i pari u mbajt më 15 mars të vitit 2020, ndërsa raundi i dytë u mbajt më 28 qershor të të njëjtit vit. Tipari dallues në procesin zgjedhor në Francë ishte votimi me përfaqësim, formë e cila u lejua në të dy raundet e votimit. Për të pasur mundësinë e përfaqësimit, kriteri i vetëm ka qenë aplikimi në stacionin policor, ose në gjykatën e shkallës së parë. Masat e tjera të obliguara nga Ministria e Brendshme ishin:<sup>4</sup>

- Vendosja e shenjave dalluese në dysheme, në mënyrë që të sigurohet mbajtja e distancës prej një metër në mes të votuesve;
- Çdo votuesi i është kërkuar marrja nga shtëpia e stilolapsit për të votuar, në mënyrë që të shmanget kontakti me objekte të cilat mund të përhapin virusin;
- Në çdo vendvotim janë vendosur posterët për respektimin e masave kundër COVID-19, në mënyrë që të jenë sa më gjithëpërfshirës;
- Dezinftuesit janë vendosur në hyrje dhe dalje të çdo vendvotimi;
- Votuesit janë detyruar të heqin maskën vetëm përkohësisht gjatë procesit të identifikimit nga komisionerët në vendvotim. Në rast të refuzimit, nuk u është mundësuar të votojnë.

### 4. Zgjedhjet Parlamentare në Korenë e Jugut

Dalja e votuesve në këto zgjedhje ishte më e larta në njëzet vitet e fundit pasi rreth

# 66%

e votuesve me të drejtë vote, kanë votuar.

Zgjedhjet Parlamentare në Korenë Jugore u mbajtën më 15 prill të vitit 2020. Koreja Jugore është ndër vendet që ka shënuar sukses në mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë COVID-19. Zgjedhjet në këtë vend u mbajtën gjatë dy ditëve, për të shmangur grumbullimin e votuesve në vendvotime. Për votuesit u hartua një 'kod i sjelljes' që udhëzon votuesit të sillen sipas disa rregullave të përshkruara si në vijim:

- Para hyrjes në vendvotim, votuesve u është kontrolluar temperatura, nëse ka qenë mbi 37 gradë, personi është lejuar të votojë në një vend special dhe pastaj është dërguar për testim;
- Nëse temperatura ka qenë nën 37 gradë, votuesi ka pasur obligim të vendosë dorëza para marrjes së fletëvotimit, dhe në dalje është vendosur një vend special për hedhjen e tyre me rastin e përfundimit të votimit;
- Personat e infektuar aktualisht me virusin COVID-19 janë lejuar të votojnë me postë;
- Qeveria lejoi votuesit që kanë qenë në vetë-izolim të marrin pjesë personalisht në zgjedhje por, duke votuar në vende speciale. Qeveria u dërgoi mesazhe me shkrim personave të vetë-izoluara duke i pyetur rreth gatishmërisë së tyre për të votuar. Kjo ka pasur për qëllim përgatitjen e duhur për mbarrëvajtjen e këtij procesi;
- Komisionerët në vendvotime ishin të obliguar të veshin kostumin mbrojtës dhe të mbajnë distancë prej tre metra nga njëri tjetri;

Zgjedhjet në Korenë e Jugut janë shembull për vendet demokratike për mënyrën e organizimit në kohë pandemie. Dalja e votuesve në këto zgjedhje ishte më e larta në njëzet vitet e fundit pasi rreth 66 për qind (%) e votuesve me të drejtë vote, kanë votuar.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> BBC News 'France's Macron defies coronavirus lockdown with elections', (Mars, 2020). Mund të gjendet në France's Macron defies coronavirus lockdown with elections - BBC News

<sup>5</sup> Vox 'This is what democracy can look like in a pandemic', (2020). Mund të gjendet në How South Korea held national elections during the coronavirus pandemic - Vox

## Mësimet e marra nga zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Podujevës

Zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Podujevës u mbajtën më 29 nëntor të vitit 2020, pas dorëheqjes së Kryetarit të Komunës Agim Veliu i cili ishte emëruar Ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës. Zgjedhjet për këtë komunë fillimisht ishin caktuar të mbahen më 15 mars, por për shkak të situatës me pandeminë, ato u shtyen për tetë muaj.

Për organizimin e zgjedhjeve në këtë komunë, KQZ miratoi udhëzimin administrativ<sup>6</sup> për masat mbrojtëse për parandalimin e infektimit me COVID-19 për votuesit dhe stafin zgjedhor në ditën e zgjedhjeve. Sipas udhëzimit në fjalë, disa nga masat e aplikuar nga votuesit përfshinin:

- Mbjajtja e maskës duke mbuluar gojën dhe hundën;
- Mbjajtja e distancës fizike prej dy metrave nga votuesit, gjatë pritjes;
- Dezinfektimi i duarve gjatë hyrjes në vendvotim;
- Gjatë prezantimit të dokumentit të identifikimit, largimi i maskës përkohësisht për t'u identifikuar nga anëtarit i Këshillit të Vendvotimit;
- Dezinfektimi i duarve gjatë daljes nga qendra e votimit.

Megjithëse respektimi i këtyre masave nuk është bërë në tërësi, vendosja e këtyre masave nga KQZ ishte vlerësuar lart nga Shefi i Zyres së BE-së në Kosovë Tomas Szunyog.<sup>7</sup> Mirëpo, pas mbylljes së vendotimeve në Komunën e Podujevës, qytetarët u mbledhën tek selia e Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke mos respektuar fare udhëzimet për mbrojtjen nga COVID-19. Shmangia e këtyre tubimeve pas zgjedhjeve është dashur të parandalohet nga policia dhe partitë politike të cilat është dashur të bëjnë thirrje që qytetarët të mos grumbullohen.

Për mosrespektim të masave të vendosura nga KQZ në zgjedhjet për Kryetar Komune në Podujevë, kanë raportuar edhe vëzhguesit e këtyre zgjedhjeve. Demokracia në Veprim (DnV), që ka monitoruar procesin zgjedhor në këtë komunë ka konstatuar se “sa i përket zbatimit të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, DnV konsideron që masat dhe procedurat e parapara të votimit përmes udhëzimit të KQZ-së, nuk janë respektuar sa duhet. Përkundër faktit që KQZ ka angazhuar ekipe monitoruese të zbatimit të masave anti-COVID, të cilat kanë qenë të pranishme në pothuajse të gjitha qendrat, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për respektim të pjesshëm të mbajtjes së maskës në mënyrë adekuate. Kjo është vënë re më shumë në radhët e komisionerëve”.<sup>8</sup> Sipas komunikatës së DnV-së, në zgjedhjet për Kryetar Komune në Podujevë nuk janë respektuar as masat e tjera siç janë distanca fizike mes votuesve dhe komisionerëve ndërsa, dezinfektimi i duarve në hyrje të qendrës së votimit është masa e cila më së paku është respektuar. Sa i përket hapësirave në qendrën e votimit, DnV ka evidentuar një numër të madh të vëzhgueseve në këto qendra, duke mos e respektuar vendimin e KQZ-së që ka paraparë vetëm një vëzhgues. Sipas kësaj organizate, “KQZ nuk ka shfrytëzuar kapacitetin e nevojshëm lidhur me hapësirat e votimit, ku në disa qendra të votimi ka pasur mbingarkim me votues, që ka rezultuar edhe me pamundësi për mbajtje të distancës”.<sup>9</sup>

Në Komunën e Podujevës mundësi votimi kanë pasur edhe personat që kanë qenë në vetë-izolim për shkak të infektimit me COVID-19. Për këtë qëllim, KQZ ka nxjerrë tjetër udhëzim administrativ<sup>10</sup> për mënyrën e votimit të personave të infektuar me COVID-19 në Komunën e Podujevës. Sipas

6 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve "Vendim për Miratimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Masat Mbrojtëse për Parandalimin e Infektimit me COVID-19 për Votuesit dhe Stafin Zgjedhor në ditën e zgjedhjeve". (2020). Mund të gjendet në 1154-2020-Vendim-per-miratimin-e-udhezimit-adm-nr-03-2020\_17-11-2020\_1.pdf [kqz-ks.org]

7 Reporter.net "Pas zgjedhjeve që u mbajtën në Podujevë, reagon zyra e BE-së në Kosovë", (Nëntor, 2020). Mund të gjendet në Pas zgjedhjeve në Podujevë dhe në veri të Mitrovicës, reagon Zyra e BE-së - Gazeta Online "Reporter.net"

8 RTK Live "DnV: Zgjedhje të qeta por pa respektim të masave anti-covid", (2020). Mund të gjendet në DnV: Zgjedhje të qeta por pa respektim të masave anti-covid [rtklive.com]

9 Po aty.

10 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve "Udhëzim Administrativ Nr. 01/2020 për identifikimin, konfirmimin dhe votimin e personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 janë në karantinë shtëpiake dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetë-izolimit", (2020). Mund të gjendet në 1092-2020-Vendim-per-udhezim\_al.pdf [kqz-ks.org]

këtij udhëzimi, personat në vetë-izolim e kanë mundësinë e votimit përmes ekipeve mobile të KQZ-së. Fillimisht këta persona janë kontaktuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) për t'u informuar rreth mundësisë që e kanë për të votuar dhe varësisht nga konfirmimi i personave të vetë-izoluar për të votuar, janë regjistruar në listat e votuesve. Sipas zëdhënësit të KQZ-së, KKZ në Komunën e Podujevës ka kontaktuar me qytetarët me të drejtë vote në komunën e Podujevës të cilët janë në karantinë shtëpiake për shkak të testit pozitiv me COVID-19. KQZ ka kontaktuar rreth 500 persona dhe gati gjysma e tyre kanë shprehur vullnetin për të votuar përmes ekipeve mobile.<sup>11</sup>

Sa i përket votimit të personave të infektuar me COVID-19 në kohën e mbajtjes së zgjedhjeve me 14 shkurt 2021, KQZ do të identifikojë qytetarët me të drejtë vote që janë pozitiv me COVID-19. Identifikimi i këtyre personave do të bëhet përmes komunikimit me institucionet që merren me menaxhimin e pandemisë dhe që i kanë listat me emrat e këtyre qytetarëve/votuesve. Votuesit do të kontaktohen përmes telefonit për t'iu shpjeguar shërbimin që mundëson KQZ për votim përmes ekipeve mobile. Në ditën e zgjedhjeve, KQZ do të dërgojë ekipet mobile në adresë të këtyre votuesve (shtëpi dhe banesa) për t'iu mundësuar votimin.<sup>12</sup>

---

<sup>11</sup> Intervistë me Valmir Elezi, Zëdhënës në Komisionin Qendror Zgjedhor. (Prishtinë, janar, 2021)

<sup>12</sup> Po aty.

## Rekomandime

Për një organizim sa më të mirë të procesit zgjedhor sidomos ditën e zgjedhjeve me 14 shkurt 2021, Kosova duhet të ndjek praktikat e mira të vendeve tjera të cilat kanë organizuar zgjedhje në kohë të pandemisë. Disa nga masat që mund të gjejnë zbatim edhe në Kosovë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, janë:

### Për KQZ:

- Reduktimi i numrit të komisionerëve dhe vëzhgueseve, për të shmangur grumbullimin e shumë personave brenda hapësirave të mbyllura;
- Zgjatja e orarit të votimit nga ora 07:00 deri në orën 21:00, për të shpërndarë votuesit në një interval më të gjatë kohor;
- Të bëhet thirrje që personat mbi moshën 65 vjeçare të votojnë në orët e paradites, kurse të tjerët të cilët nuk e kanë të domosdoshme votimin gjatë paradites, të votojnë pasdite. Në këtë mënyrë zvogëlohet mundësia e përhapjes së virusit tek personat më të vjetër në moshë;
- Të shtohet numri i qendrave të votimit dhe vendvotimeve me qëllim të reduktimit të votuesve të cilët frekuentojnë këto qendra dhe atyre të cilët presin në radhë për të votuar;
- Të rregullohet mënyra e votimit për personat e vetë-izoluara, duke i angazhuar ekipet mobile të KQZ-së me përkrahje nga stafi i Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë që t'u ofrohet mundësia e barabartë e votimit me personat e tjerë;
- Vendosja e dezinfektuesve në hyrje dhe dalje të çdo vendvotimi;
- Vendosja e mburojave plastike në mes të votuesve dhe komisionerëve;
- Dezinfektimi i objekteve çdo tri orë, si: dorezat e derës së vendvotimit, kabina e votimit, kutia e fletëvotimeve, vulat, spërkatësit për identifikim, tryezat etj;
- Ajrosja e hapësirave të vendvotimit të bëhet çdo orë, nga dhjetë minuta;
- Për të ruajtur distancën mes votuesve është e domosdoshme vendosja e shenjave dalluese në dysheme, në mënyrë që votuesit ta kenë të qartë vendin ku të presin në radhë sipas kategorive, dhe t'i vendos ato në faqen e internetit. Kjo e fundit duhet të plotësohet me të dhëna mbi procesin, përfshirë sa njerëz vaksionohen, kush dhe ku, në mënyrë që qytetarët të kenë një pasqyrë të përgjithshme se si po përparon procesi.

### Për Qeverinë:

- Për të shmangur grumbullimin e personave pas përfundimit të procesit të votimit, rekomandohet vendosja e orës policore në tërë vendin duke filluar nga ora 21:30. Kjo me qëllim evitimin e gabimit që është bërë në këtë aspekt në Komunën e Podujevës.

### Për Votuesit:

- Mbajtja e maskave gjatë procesit zgjedhor;
- Votuesit duhet të marrin stilolapsin me vete nga shtëpia, për të shmangur kështu prekjen e një objekti nga shumë persona;
- Të evitojnë grumbullimet dhe respektojnë distancën prej 1.5 metra në pritje për votim.